REZOLUTË
PËR RAPORTIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM "MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2011"

Duke konsideruar se:

- Prokuroria e Republikës së Shqipërisë është institucioni kushtetues, i ngarkuar me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit;

- Lufta kundër kriminalitetit është e suksesshme vetëm duke ushtruar një ndjekje penale efektive dhe profesionale, e realizuar nga një institucion solid, i pavarur, i përgjegjshëm dhe profesional në zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjeve;

- Lufta kundër kriminalitetit, me fokus të veçantë krimin e organizuar dhe korrupsionin, si dhe forcimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së institucionit të Prokurorisë, përbëjnë përparësi kyçe për Republikën e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton për vitin 2011:

- Siç rezulton nga raporti, që i është paraqitur Kuvendit, gjendja e kriminalitetit paraqitet me një reduktim të intensitetit dhe të disa formave të krimit, si dhe të rritjes së koeficientit të kriminalitetit, sidomos për disa vepra penale të caktuara.

- Janë intensifikuar përpjekjet në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore, gjë e cila ka sjellë në vijimësi uljen e ndjeshme të këtij fenomeni.

- Ekziston vullneti për të intensifikuar luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike, por ka nevojë për të ashpërsuar politikën penale në trajtimin dhe ndjekjen e këtyre rasteve, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së Prokurorisë.

- Konfiskimi civil i aseteve që rrjedhin nga veprimtaria e krimit të organizuar dhe trafikimit, në zbatim të ligjit "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", është rritur dhe forcuar gjatë vitit 2011.

- Bashkëpunimi mes Prokurorisë dhe institucioneve të tjera gjatë vitit 2011 ka sjellë impakt pozitiv në luftën kundër kriminalitetit dhe shembull domethënës janë funksionimi i grupeve task-forcë. Ka përpjekje për të intensifikuar bashkëpunimin nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis institucioneve.

- Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë vijojnë të jenë të mira dhe treguesit e procesit të ekstradimit të shtetasve janë pozitive.

Kuvendi kërkon nga Prokuroria për vitin 2012:

- Të intensifikohet veprimtaria hetimore, veçanërisht në drejtim të reduktimit të çështjeve të pezulluara dhe çështjeve të pushuara, të cilat janë filluar kryesisht nga vetë Prokuroria;

- Të intensifikojë luftën ndaj të gjitha formave të krimit, trafiqeve dhe krimit të organizuar, veçanërisht në ndërtimin e një vizioni të qartë për forcimin dhe ashpërsimin e politikës penale ndaj këtyre veprave;

- Të rrisë bashkëpunimin me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit në Shqipëri nëpërmjet bashkëpunimit dhe vizionit të përbashkët për zero tolerancë ndaj krimit;

- Të vijojë rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë homologe, në zbatim të legjislacionit në këtë fushë;

- Të intensifikojë luftën ndaj korrupsionit në administratën qendrore dhe në atë vendore ndaj zyrtarëve dhe ndaj ish-zyrtarëve, duke kryer hetime proaktive, të shpejta dhe efikase, si dhe duke mbajtur regjistrim të njëjtë të rasteve, që nga referimi i tyre deri në ekzekutimin e vendimeve. Në mënyrë të veçantë, lufta ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë të jetë një përparësi themelore e Prokurorisë, duke forcuar kapacitetet investigative dhe duke ndryshuar mentalitetin për frymë korporativiste në këtë sistem;

- Të analizojë me përgjegjshmëri maksimale gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë për politikën penale dhe marrjen e masave efektive për përmbushjen e tyre;

- Të marrë masat e duhura për zbatimin e legjislacionit procedural penal për ruajtjen e sekretit hetimor, për ndalimin e publikimit të akteve procedurale dhe ndëshkimin e autorëve të nxjerrjes së tyre, sipas legjislacionit penal në fuqi;

- Të zhvillohen procedura transparente dhe larg konfliktit të interesit për emërimin, transferimin dhe karrierën e prokurorëve në sistemin e Prokurorisë;

- Të tregojë përgjegjshmëri të lartë dhe të ushtrojë vetëkritikë për nivelin e ulët të rezultateve nga bashkëpunimi me KLSH-në, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive apo agjenci të tjera në fushën e luftës ndaj kriminalitetit. Suksesi i këtij bashkëpunimi është kriter i mirëfilltë për veprimin e shtetit ligjor dhe të masave antikorrupsion, për të cilin organi i Prokurorisë është përgjegjësi kryesor dhe vendimtar;

- Të zbatojë me përpikëri dhe pa vonesë vendimet gjyqësore, të cilat prekin sistemin e Prokurorisë, si pjesë e procesit të rregullt ligjor.

19 korrik 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)